



Thirrje për aplikim për Trajnimin e Trajnerëve

Tema: “Mobilizimi i burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile”

Qëndrueshmëria financiare e organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) është një ndër sfidat më të mëdha të zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile. Në Kosovë, përkrahja më e madhe financiare e OShC-ve vjen nga donatorët ndërkombëtar, dhe rrjedhimisht zhvillimi i sektorit varet kryesisht nga kjo përkrahje. Me zvogëlimin e këtyre fondeve rrezikohet edhe qëndrueshmëria dhe zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të shoqërisë civile. Andaj, është e domosdoshme që të eksploroohen mundësitë për llojllojshmëritë e resurseve. Llojllojshmëria e resurseve financiare dhe jo-financiare për shoqërinë civile nënkupton identifikimin dhe mobilizimin e mbështetjes alternative vendore financiare si dhe kontributin përmes mbështetjes vullnetare nga qytetarët, sektori privat, puna vullnetare, ekspertët, si në Kosovë ashtu edhe nga diaspora. Burimet shitesë do të mundësojnë që OShC-të të jenë më të suksesshme në zbatimin e misionit të tyre, të ripërtërijnë lidhjen me konstituencën, si dhe të rrisin llogaridhënien dhe transparencën në raport me qytetarët.

Me qëllim që të adresojë çështjen e qëndrueshmërisë së burimeve të shoqërisë civile, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) përmes **Programit për Angazhim Qytetar (CEA)** të cilin e zbaton në partneritet me USAID në Kosovë, **prej 21 deri 23 Tetor 2022** do të organizojë trajnimin e trajnerëve në temën **“Mobilizimi i burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile”**.

Trajnimi që do të ofrohet nga partneri i KCSF-së, Catalyst Balkans dhe ka për qëllim të transformojmë shoqërinë civile kosovare duke prezantuar modele për mbledhjen e fondeve nga komuniteti dhe duke ndërtuar lidhje më të forta ndërmjet OShC-ve dhe konstituencës së tyre. Ndryshimi më i mirë dhe më domethënës është ai që vjen nga brenda.

Roli i trajnerëve

Roli i trajnerëve në këtë proces është të ndihmojë OShC-të që t'i qasen në mënyrë strategjike dhe sistematike temës së mbledhjes së fondeve nga komuniteti, në mënyrë që të sigurohet mbështetja nga qytetarët, komuniteti dhe bizneset lokale përmes modeleve dhe fushatave të ndryshme të mbledhjes së fondeve. Këto modele përfshijnë, duke mos u kufizuar në: modelin e bazuar në donacione, pagesë të anëtarësisë, mbledhjen e fondeve për kauza të përbashkëta (crowdfunding), fushata individuale për mbledhje të fondeve (peer-to-peer), ankande bamirësie, ngjarje për mbledhjen e fondeve, partneritete, kuti donacionesh, fushata të ndryshme përmes kanaleve digjitale, etj.

Trajnerët do të kenë rol të rëndësishëm në zbatimin e një modeli të kombinuar të mësimit për OShC-të që do të aplikohet në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar të përbërë nga:

- Kurse të veçanta përmes platformës online të edukimit mbi promovimin dhe mbledhjen e fondeve për OShC-të ku pjesëmarrësit mund të qasen në çdo kohë;
- Mbështetje dhe mentorim të trajnerëve/eve para dhe pas trajnimit; dhe
- Përgatitja dhe lansimi i fushatave për OShC-të në mbledhje të fondeve me mbështetje dhe këshillim të vazhdueshëm mentorimi.

Kush mund të aplikojë dhe cilat janë kriteret?

Personat me përvojë dhe interesim për organizimin e shoqërisë civile dhe aktivizimin në komunitet rekomandohen fuqimisht të aplikojnë. Përvojat e mëhershme në ngritje të fondeve për shoqëri civile, puna në hartim të kampanjave dhe raporteve financiare konsiderohet si përparësi. KCSF inkurajon gjithpërfshirje nga aspekti gjinor, i etnisë, përfaqësimit gjeografik nga të gjitha rajonet e Kosovës.

Kandidatët dhe kandidatet për trajnerë/e duhet:

- Të jenë në dispozicion dhe të përkushtuar për t'u angazhuar si trajnerë/e/ në mentorim të OShC-ve përfituese për mobilizim dhe diversifikim të resurseve të tyre;
- Të kenë përvojë dhe interesim për zhvillimet e shoqërisë civile dhe aktivizëm në komunitet. Përvoja në konsulencë paraprake mund të konsiderohet përparësi;
- Të kenë njohuri bazë mbi tendencat e përgjithshme të dhënies nga biznesi bashkë me sfidat e OShC-ve për mbledhjen e fondeve;
- Të kenë përvojë në mbledhjen e fondeve në komunitet ose fusha të ngjashme si promovimi (digjital), komunikimi, planifikimi i biznesit, ndërtimi i kapaciteteve dhe fushatat e grumbullimit të fondeve, etj;
- Të kenë përvojë në organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve apo programeve të edukimit joformal;
- Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikuese (moderim, komunikim dhe prezantim).
- Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Të kenë diplomë në nivelin bachelor;
- Të mos jenë të angazhuar në ndonjë parti politike në katër vitet e fundit.

Si të aplikoj?

Për të marrë pjesë në Trajnimin për Trajnerë në temën “Mobilizimi i burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile”, të interesuarit dhe të interesuarat duhet të plotësojnë formularin online të aplikimit në: <https://www.surveymonkey.com/r/formulariperaplikim>.



Në formular përpos të dhënave që kërkohen duhet të ngarkoni edhe:

- CV-në e detajuar, me fokus në përvojën relevante për temat përkatëse; dhe
- Dëshmi të përvojave të ngjashme (nëse keni).

Formulari i aplikimit mund të plotësohet në gjuhën shqipe ose serbe.

Afati i fundit për aplikim

6 tetor 2022.

Informata logjistike

Trajnimi i Trajnerëve në temën “Mobilizimi i burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile” do të mbahet **nga data: 21 deri 23 tetor 2022 në Kosovë**. Pjesëmarrësve të përzgjedhur do t'u kërkohet të jenë fizikisht të pranishëm gjatë tre ditëve të trajnimit. Shpenzimet e transportit dhe akomodimit do të mbulohen nga KCSF. Informata më të hollësishme do t'u dërgohen kandidatëve të suksesshëm përmes ftesës pas pranimit të tyre në programin trajnimit.

Pritjet nga të certifikuarit e Trajnimit për Trajner/e:

Trajnerët dhe trajneret e ardhshëm/me pritjet të:

- udhëzojnë OShC-të, udhëheqësi ne e tyre, stafin, aktivistët dhe/ose vullnetarët që janë përfitues të programit CEA dhe kanë marrë pjesë në kurset e promovimit dhe mbledhjes së fondeve;
- japin komente dhe sugjerime për detyrat gjatë këtyre kurseve që do ti mbajnë OShC-të (modeli i mbledhjes së fondeve, plani i fushatës, përmbajtja e fushatës);
- të japin shpjegime më të thella për OShC-të pjesëmarrëse rreth koncepteve dhe mjeteve të paraqitura në kurse;
- të jenë në gjendje të ndërtojnë partneritete me donatorë të korporatave dhe të kuptojnë diasporën, si dhe arsyet kryesore që i shtynjë ata/ato të dhurojnë fonde, dhe të përdorin këtë potencial për iniciativa të qëndrueshme;
- këshillojnë përfituesit në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të tyre për mbledhjen e fondeve;
- të mbajnë raporte të rregullta me përfituesit;
- inkurajojnë OShC-të përfituese që të kenë angazhim të vazhdueshëm;

- të inkurajojë të mësuarit mes OShC-ve nga përvojat e tyre të përbashkëta;
- t'i raportojë KCSF-së mbi procesin e mentorimit dhe suksesin e përfituesve;
- të mbështesin punën logjistike të organizimit të trajnimit të OShC-ve për temën e mobilizimit të resurseve.

Pjesëmarrësit e certifikuar në trajnim do të bëhen pjesë e grupit të trajnerëve dhe trajnereve për t'u angazhuar në kuadër të trajnimit të OShC-ve në temën e mobilizimit të resurseve.

Angazhimi i tyre do të ketë kompensim financiar.

Informata më të gjëra për programin dhe trajnimin

Programi për Angazhim Qytetar (CEA) është iniciativë pesë vjeçare që zbatohet nga KCSF në partneritet me USAID në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij partneriteti është të ushqejë kulturën e aktivizimit që e bën jetën në lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të kujdesshme dhe më kuptimplotë. Nëpërmjet aktiviteteve të tij, Programi CEA do të realizojë një numër të veprimeve të bazuara në tre shtylla thelbësore: angazhimin e komunitetit, rritjen e besimit ndër-shoqëror si dhe zgjerimin e mobilizimit të burimeve të reja.

Trajnimit për trajnerë në temën e mobilizimit të burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizata të shoqërisë civile paraqet një nga aktivitetet e shtyllës së tretë të programit ku do të përfitojnë deri në 20 persona që do të përkrahin dhe mentorojnë OShC-të në përgatitje të kampanjave të tyre për ngritje të fondeve.

Duke u bazuar në ekspertizën ekzistuese të KCSF-së dhe organizatës partnere Catalyst Balkans, është zhvilluar një kurrikulë që i përshtatet nevojave të OShC-ve bazuar edhe në vet kontributin e OShC-ve e cila është grumbulluar përmes një pyetësori që është shpërndarë në muajt paraprak. Modulet e trajnimit do të dizajnohen në mënyrë progresive, me dy module bazë më të shkurtra të zhvilluara për t'u ofruar përmes një platforme të mësimit elektronik si trajnimit i parë bazik dhe module më të avancuara të zhvilluara dhe ofruara si trajnime të veçanta përmes takimeve e punëtorive të fokusuara. Temat ilustruese që do të trajtohen gjatë trajnimeve janë paraqitur si më poshtë:

- Hartëzimi i aseteve/burimeve të komunitetit;
- Ndërtimi i partneriteteve me donatorët nga komuniteti i biznesit;
- Përdorimi i fushatave dhe ngjarjeve për të mobilizuar burimet e komunitetit;
- Mjete dhe këshilla për mbledhjen e fondeve nga individët;
- Të kuptuarit e diasporës, dhe pse jep fonde;
- Përdorimi i teknologjisë për të angazhuar konstituencën dhe për të mobilizuar burimet.

Pas kryerjes së trajnimit, stafi i Catalyst do të ofrojë mentorim, trajnim dhe monitorim të vazhdueshëm për trajnerët në mënyrë që të sigurohet edukim i vazhdueshëm cilësor për



mobilizimin e burimeve vendore. Për më shumë informata për Catalyst Balkans vizitoni web-faqen: <https://catalystbalkans.org/en>.

Informata shtesë

Për informata shtesë ose sqarime të mëtejshme për këtë thirrje, ju lutemi të mos hezitoni të kontaktoni me e-mail tek: enes.toska@kcsfoundation.org.